

---

## SOCIOLOGY OF COMMUNICATIONS BETWEEN PESIMISM AND MODERNIZATION

**Abdulnaser Sinani**

University of Tetova, Republic of North Macedonia, abdulnaser.sinani@unite.edu.mk

**Faton Murseli**

University of Tetova, Republic of North Macedonia, faton.murseli@unite.edu.mk

**Abstract:** Communication today in both classical and new media has changed not only its way and access to interpersonal communications, but also in social relations. The world today, more than ever before, is in a struggle between classical communications, always overwhelmed by the pessimism of social developments, with new or modernized communications. Many scholars have put forward theories that testify to this war, even in the social context, that they make comparisons or connections of communication between two sides of the Atlantic. The first one is on the sociological plane between European sociology and the second one on American pragmatism. These relate in particular to the claims of the American empirical school and the Frankfurt school as well as to Habermasian and post-Habermasian theories of public space.

This paper attempts to highlight this "war" that has a profound social impact on our lifestyles, approaches to various problems, combating misinformation or even harmful political decision-making. Therefore, the purpose of this paper is to move away from the negative effects stimulated by this communicological transformation, to show that public action is not merely a passive conformism, to show that society is rational and dynamic, and that there are no externalities or absolute superiority of intellectuals. In addition, the paper will not eliminate the critics of negative phenomena whether they are consequences of shallow thoughts or low interests, or due to the lack of legal regulations in the Balkans and specifically in the Republic of Northern Macedonia, which would condemn the inclusion of negative innovations, misguided, and as consequence harmful to society.

The paper will have a positive approach to today's technological developments that affect communication and social life in general. It will be an alarm case for intentional or unintentional deviations, which give alert for wrong decisions that result from sociological deviations in communication. The point of this paper is to present a basis for study or concern, for this global transformation where local institutional issues have already taken on broad transnational character. In this context, caring for communication, especially its regular social development, would contribute to raising new dimensions of its true ideals of ethnic, political or even religious pluralism, and would represent the true ideal of not abandoning the vision of an open, multidimensional world. These are some of the most sensitive issues in the world, especially the Balkans, which will be approached with a positive and progressive look.

This paper will be conducted through the survey method, and the content analysis. The public, especially the educated and critical public in the Republic of Northern Macedonia, as well as some of the traditional media and news portals in RMV, are subject of observation. In addition to the problematic rise that we claim to be world-specific but Balkan-specific, the work will extend to the communicational and sociological reality of the Republic of Northern Macedonia.

**Keywords:** communication sociology, transformation / transition, sociological modernization, mass sociology.

## SOCIOLOGJIA E KOMUNIKIMEVE MES PESIMIZMIT DHE MODERNIZIMIT

**Abdulnaser Sinani**

University of Tetova, Republic of North Macedonia, abdulnaser.sinani@unite.edu.mk

**Faton Murseli**

University of Tetova, Republic of North Macedonia, faton.murseli@unite.edu.mk

**Abstract:** Komunikimet si ato klasike ashtu edhe mediat e reja, kanë ndryshuar sot, jo vetëm mënyrën dhe qasjen në komunikimet interpersonale, por edhe në raportet sociale. Bota sot më shumë se çdo herë më parë gjendet në një luftë mes komunikimeve klasike, të kapluara gjithnjë nga pesimizmi i zhvillimeve sociale, me komunikimet e reja apo të modernizuara. Shumë studiues kanë hedhur teori që dëshmojnë për këtë luftë madje në rrafshin social ata bëjnë krahasimin apo lidhjet e komunikimeve mes dy anëve të Atlantikut, edhe në rrafshin sociologjik mes sociologjisë evropiane dhe pragmatizmit amerikan. Këto lidhen sidomos me pohimet e shkollës empirike amerikane dhe të shkollës së Frankfurtit si dhe në teoritë habermasiane dhe post-habermasiane të hapësirës publike. Ky punim,

tenton të vë në pah këtë “luftë” që është me ndikim të thellë social mbi mënyrën e jetesës tonë, qasjet ndaj problematikave të ndryshme, luftimin e dezinformimeve apo edhe të vendim-marjeve të dëmshme politike. Andaj, qëllimi i punimit është të largohet nga efektet negative që stimulon ky transformim komunikologjik, të tregojë se veprimi i publikut nuk është thjesht një konformizëm pasiv, të tregojë se shoqëria është e arsyeshme dhe dinamike dhe se nuk ekzistojnë jashtësi apo epërsi absolute të intelektualëve. Krahas kësaj, ky punim nuk pretendon të eliminojë kritikën ndaj fenomeneve negative qoftë si pasojë e mendimeve të cekta apo interesave të ulta, apo edhe si pasojë e mungesës së rregullativave ligjore në Ballkan dhe konkretisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që do të dënonin ndërfitjen e risive negative, të devijuara, e si pasojë të dëmshme për shoqërinë.

Punimi pikënisje ka një qasje pozitiviste, të zhvillimeve të sotme teknologjike, që ndikonjë komunikimet dhe jetën sociale në përgjithësi. Do të jetë një rast alarmi për devijimet e qëllimshme ose jo, e të cilat sjellin alarm për vendim-marje të gabuara, që vijnë si pasojë e devijimeve sociologjike në komunikim. Çështja është që punimi të paraqes një bazë studimi apo shqetësimi, për këtë transformim global ku çështjet institucionale vendore tashmë kanë marrë karaktere të gjera transkombëtare. Në këtë kontekst, kujdesi ndaj komunikimit, veçanërisht zhvillimi i tij i rregullt social, do të kontribonte në ngritjen e dimensioneve të reja të idealeve të vërteta të tij për pluralizëm etnik, politik apo edhe fetar, dhe do të përfaqësonte idealin e vërtetë për të mos braktisur vizionin e botës së hapur e shumëdimensionale. Këto janë disa çështje të ndjeshme botërore, e sidomos Ballkanike, të cilave punimi do ju qaset me një sy pozitivist dhe progresiv.

Ky punim përmes metodës së anketimit, dhe të analizës së përmbajtjes. objekt vëzhgimi ka opinionin publik, sidomos atë të arsimuar e kritik, në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe disa nga mediat tradicionale dhe portalet informative në RMV. Përpos një ngritje problematike që mëtojmë të jetë botërore, por specifike Ballkanike, punimi do të shtrihet në rrealitetin komunikologjik e sociologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Fjalë kyçe:** sociologjia e komunikimeve, tranzicioni, modernizimi komunikologjik, sociologjia masive.

## 1. HYRJE

Tranzicioni në të cilin gjendet procesi i komunikimit në raport me shoqërinë, vjen pas tranzicionit të shteteve sidomos në Ballkan, që me gjasë duhet ta kishin kaluar edhe shtetet e zhvilluara botërore sot nga të cilat ne marrim shembujt të avancuar të komunikimeve sociologjike. Tranzicioni i shteteve si duket ka nënkuptuar atë ekonomik, meqë me zhvillimin ekonomik shtetet kanë investuar në digjitalizimin e mesazheve dhe si rrjedhojë gjendemi në një tranzicion komunikologjik. Gjithnjë flasim për një komunikim masiv, e kur kemi parasysh këtë nënkuptojmë shoqërinë. Ky tranzicion ka kuptimin e zhvillimit socio-komunikologjik nga një masivizim tek pragmatizmi amerikan. Kjo merret si përcaktues i Shkollës së Çikagos, nën drejtimin e Robert E. Park-ut, ishte e para që hodhi bazat e një studimi etnografik të shtypit (Maigret, 2010). Mesazhi “ynë” sot ka marrë mërmësa më të gjera të shtrirjes sa edhe vet përbërja, kuptimi dhe strategjia e tij është avancuar nga ai kombëtar në internacional. Në kohën e sotme as vendet ballkanike nuk mund të shkëputen nga temat e madha internacionale, ndërkaq për këtë nevojitet një trajnim dhe studim i duhur i dy shkencave që si duket vetëm këtu nuk mund të shkojnë ndaras, sociologjisë dhe komunikimit. Në vendet ballkanike, dhe sidomos në rrealitetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ky tranzicion, ashtu sikurse i pasi ka sjellë vonesa të mëdha. Prandaj, paraqiten dhe janë të zhvilluara forma devijante komunikologjike, të cilat paraqesin gjithashtu edhe probleme në rrafshet globale.

## 2. PARIMET DH E KËRKESAT E NJË TRANZICIONI TË DUHUR

Kuptohet që ka studime ndërkombëtare të ndikimit të mas-mediaeve apo medieve të reja në transformimin që i kanë bërë mesazhit me zhvillimin e sotëm të teknikës dhe të teknologjisë. Univrsitete me famë botërore si i “Oxford” apo “Cambridge”, përmes metodës kryesisht të anketimit kanë vënë në pah rritjen e dukshme të përdorimit të mediave të reja e sidomos të rrjeteve sociale në pesëvjeçarin e fundt. Kjo rritje dhe ndikim është vërrejtur në vendet ballkanike, ndërsa kryesues i rritjes së përdorimit të rrjeteve sociale është edhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Për këtë shkak nevojitet:

Parimi i parë: Përshtatja me procesin e ndryshimeve botërore të sociologjisë së komunikimeve. Që një shoqëri të ekzistojë, është i nevojshëm të zhvillohet procesi i komunikimit (Dominick, 2010). Këto ndryshime edhe pse në botë kanë ndodhur në një kohëzgjatje nga tre deri në pesë vjet, në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdojnë më shumë se pesë vite. Nuk gjindet një kod i mirëfillt komunikologjik, andaj vlerësojmë se gjendemi në një situatë kaotike informative, gjë të cilën e shfrytëzojnë grupet e interesit për arritjen e qëllimeve të tyre. Shënohet një rritje e madhe e mosprofesionalizmit në fushën e informimeve publike, proces i cili ka zbehur aktualisht besueshmërinë dhe ndikimin e tyre.

Parimi i dytë 2: Një informim sipërfaqësor i opinionit dhe njohje me teoritë bazë të komunikimit. Opinioni publik, masat, gjegjësisht shoqëria duhet të kthehet në një masë kritike më shumë se sa një konsumues pasiv i gjithçkaje që

plasojnë mediat. Kështu më lehtë do të dallohen dhe evidentohen jokorrektësitë komunikologjike, propaganda apo marketingu, por edhe lajmet e rrejshme të cilat krijojnë huti dhe aspak dobi marë në aspektin e analizës së ndikimit të informacionit në shoqëri (Bon, 2014). Me një trajnim apo informim sipërfaqësorë të “trukeve” komunikologjike, shoqëria do të ishte më agjile, për ndikimet e dëmshme që i vijnë e që mbartin pasoja të rënda.

Parimi i tretë: Trajnim i gazetarëve dhe gjithë puntorëve mediatik dhe rritje e profesionalitetit të tyre. Sot gjithkush ka të drejtën të shkruajë një lajm apo ngjarje në media, por edhe të informojë apo dezinformojë. Dy janë kërkesat imanente, e para, vendosja e një sistemi kontrolli institucional mbi shkollimin dhe trajnimin e gazetarëve, dhe e dyta rritja e ndëgjegjes individuale dhe kolektive, në veçanti thirrja te kodekseve etike dhe për përgjegjësinë sociale që bartin mediat. E drejta e informimit është e drejtë globale e garantuar, mirëpo e drejta për të informuar duhet të jetë në përmasa të etikës dhe ndershmërisë dhe me misionin e vërtetë të shkencës komunikologjike për avancim të përgjithshëm social.

Parimi i katërtë: Vendosja e kontrollit mbi mediat e reja. Licencimi dhe kontrolli i medieve të reja nga ana e shtetit do të pamundësojë keqpërdorime të komunikimeve për arritje të qëllimeve të caktuar që dëmtojnë imazhin e ndonjë personi me qëllim diskreditimi apo institucioni në tërësi ((MCIC), 2007). Në kohën e sotme kaosin informativ e përhapin mediat e palicencuara “online”, apo portalet informative, të cilat më pastaj nuk bartin asnjë përgjegjësi ligjore.

Principi nr. 5: Futja e risive inovacioneve. Risitë apo inovacionet gjithnjë në aspektin e avancimeve shoqërore janë të pashmangshme edhe për realitetin e RMV-së. Kështu sot, me përparimet teknike dhe teknologjike, mesazhi jo vetëm që ka një shtrirje më të gjerë, por duhet të jetë i strukturuar si në përmbajtje ashtu edhe në formë. Risitë teknologjike multimediale janë shumë pak të zhvilluara në RMV, ndërkaq komunikologët dinjë pak për format e reja komunikologjike si komunikimet hibride apo kibernetike. Zhvillimi dhe avancimi i tyre do të ishte zhvillim shtetëror, nënkuptohet edhe social.

### 3. TRANZICION I DUHUR SOCIO-KOMUNIKOLOGJIK

Tranzicioni socio-komunikologjik të cilin me vështirësi e keqkuptime e kalon Republika e Maqedonisë së Veriut ka nevojë dhe mundësi të përmirësohet nëpërmjet:

1. *Vendosjes së standardeve të reja komunikologjike.* Kjo nënkupton përmirësim “raportesh” mes indikatorëve komunikologjik me masat apo shoqërinë. Duhet të dihet se synimi i tyre i përbashkët është avancimi i sferave të caktuara. Dhe pa një avancim raportesh pozitive dhe bashkëpunim nuk mund të arrihet qëllimi human individual, dhe human social parë në sferën socio-komunikologjike.

2. *Krijim i raporteve korrekte të medieve me grupet e interesit.* Ky raport duhet të jetë jo vetëm ndikues për interesat personale dhe grupore të grupeve të interesit ndaj opinionit publik, por të tejkalojë në përmasën e të mirave sociale. Grupe interesi të veçanta e që në mënyrë më të madhe e të shpeshtë keqpërdorin komunikimin janë partitë politike, të cilat duhet të avncojnë etikën politike dhe mënyrën e rraporteve të tyre me mediat. Krahasuar kjo me sistemet monise, ku siç shkruan Gjilas, “roli udhëheqës i partisë” nuk është sanksionuar me ndonjë ligji por ai shpërndahet në të gjitha organizatat dhe në çdo sektor të veprimtarisë (Gjilas, 2006). Mediat e reja duhet të kenë burime konstante financimi të rregulluara përmes ligjeve shtetërore në mënyrë që të mos bien pre e interesave të ngushta individuale apo grupeve.

3. *Studim i mirëfilltë sociologjik.* Një studim si nga komunikologët ashtu edhe nga sociologët për problematikën e vërteta sociale është i domosdoshëm. Problematikat sociale në sfera nacionale në rradhë të parë më pastaj edhe për një kontribut të gjerë internacional. Në shembullin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, tejkalimi i problematikave më shumë të karaktereve politike të multietnicitetit të vendit apo multikonfesionalitetit të tij. Këto pastaj influencojnë edhe në tranzicionin e ngadaltë socio-komunikologjik dhe si pasojë janë parakusht për krijimin e fenomeneve devijante komunikologjike të cilat “helmojnë” shoqërinë.

4. *Digjitalizimi institucional.* Sjellja institucionale është e patjetërsueshme të trajnohet dhe përmirësohet në vendet ballkanike dhe sidomos në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përfaqësuesit shtetëror të zgjedhur nga vota e popullit me ndërgjegje duhet të kuptojnë se janë aty për zgjedhjen e problematikave sociale, pa bërë kurfarë dallimesh. Kjo mund të arrihet edhe me avancimin e formave të reja komunikologjike, si digjitalizimin e komunikimit institucion-opinion publik.

### 4. PËRFUNDIM

Faza e turbulltë dhe e rëndë komunikologjike ku ndodhet Republika e Maqedonisë së Veriut, e që ndikon në mënyrë të papërmirësueshme shoqërinë, është pasojë e ndryshimit të qasjes nga nacionale në internacionale të mesazhit, me zhvillimin e madh tekniko-teknologjik sidomos pesëvjeçarin e fundit. Këtë fazë e kemi emëruar si tranzicion (transformim) socio-komunikologjik, veti të cilat janë identifikuar edhe në vende të zhvilluara botërore, parë gjithnjë

---

në këtë sferë. Probleme të ndryshme, ekzistojnë edhe sot në botë dhe identifikohen si globale, ndërkaq Republika e Maqedonisë së Veriut shënon një sërë problemesh tjera në këtë sferë që vijnë si pasojë e mosinteresimit të institucioneve shtetërore për rregullativa të caktuara ligjore, e të cilat po vazhduan do të lënë pasojë të mëdha e afatgjate sociale.

#### LITERATURA

- Amenta, E., Nash, K dhe Scott. A. (2016) *The Wiley-Blackwell Companion to Political Sociology*. UK. Fq. 52.
- Balibar, E. (2015) *Citizenship*. Cambridge” Polity.
- Beer, D. (2014). *Punk sociology*. Houndmills: Palgrave/Macmillan. Fq.103
- Bon, G. L. (2014). *Psikologjia e masave dhe e turmave*. Tiranë: Fan Noli.
- Dominick, J. R. (2010). *Dinamika e komunikimit masiv, Media në periudhën digjitale*. Tiranë: UET Press.
- Edgel S, Gottfried H. & Granter E. (2015). *Handbook of the Sociology of Work and Employment*. London UK. Fq. 190-194. SAGE Handbook
- Gjilas, M. (2006). *Fytyra e totalitarizmit*. Tiranë: Fan Noli.
- Goci, E. (2015). Ku mbarojnë mediat klasike dhe ku fillojnë mediat e reja?  
<https://monitorimedias.wordpress.com/2013/01/25/ku-mbarojne-mediat-klasike-dhe-ku-fillojne-mediat-e-reja/>
- Kadriu, I. (2019). *Sociologjia politike*. Tetovë RMV. Arberia Design. fq. 98
- Lupton, D. (2015) *Digital Sociology*. London. Fq. 32-37.
- Maigret, E. (2010). *Sociologjia e komunikimit dhe e mediave*. Tiranë: Papirus.
- McLuhan, M. (2001). *The Global Village: Transformations in World Life and Media in the 21st Century*. Shkup. Fq.145-150.
- (MCIC), Q. M. (2007). *Marrëdhëniet me median - Udhëzues*. 54.
- Štular, B., (2012). “*Knjiga - novi medij?*” *Knjižnica*, letnik 56, številka 3, fq. 223-231.